VENDIM
Nr. 851, datë 21.10.2015

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT FEDERAL ZVICERAN, PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR PROJEKTIN "INSTALIMI I DMFAS 6 TË UNCTAD-IT NË MINISTRINË E FINANCAVE TË SHQIPËRISË DHE NGRITJA E KAPACITETEVE PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË BORXHIT NË SHQIPËRI"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit Federal Zviceran, për dhënien e ndihmës financiare për projektin "Instalimi i DMFAS 6 të UNCTAD-it në Ministrinë e Financave të Shqipërisë dhe ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e integruar të borxhit në Shqipëri", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE

Ndërmjet Këshillit Federal Zviceran dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për dhënien e ndihmës financiare për projektin "Instalimi i DMFAS 6 të UNCTAD-it në ministrinë e Financave të Shqipërisë dhe ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e integruar të borxhit në Shqipëri"

Këshilli Federal i Zvicrës, i përfaqësuar nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike, më poshtë i referuar si SECO dhe

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financës, më poshtë të referuara bashkërisht si Palë Kontraktuese,

Duke u mbështetur në parimet e bashkëpunimit të përcaktuara në Marrëveshjen ndërmjet Këshillit Federal të Zvicrës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në lidhje me Bashkëpunimin Teknik, Financiar dhe Humanitar të datës 11 maj 2007,

kanë rënë dakord si më poshtë:

1. SECO bie dakord t'i dhurojë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave, kontributin e parimbursueshëm në shumën maksimale 453'500 USD për përmirësimin e Sistemit të Menaxhimit të Borxhit dhe Analizës Financiare (DMFAS) nga versioni 5.3 (aktualisht në përdorim) në versionin 6 dhe Ndërtimin e Kapaciteteve për Menaxhimin e Integruar të Borxhit në Shqipëri (projekti).

Qëllimi i këtij projekti është forcimi i kapacitetit teknik dhe funksional të Ministrisë së Financave të Shqipërisë për të regjistruar, përpunuar, monitoruar, raportuar, shpërndarë dhe analizuar borxhin e brendshëm dhe të jashtëm publik të vendit. Në veçanti, projekti synon ta arrijë këtë nëpërmjet instalimit të DMFAS 6 të UNCTAD-së (Konferenca e OKB-së për Tregtinë dhe Zhvillimin) në Ministrinë e Financave të Shqipërisë, konsolidimit të të dhënave për borxhin e jashtëm dhe të brendshëm publik, sigurimin e trajnimit për ndërtim kapacitetesh për menaxherët e borxhit, si dhe nëpërmjet krijimit të një ndërfaqeje të menaxhimit të borxhit me sistemin AFMIS.

2. Ky projekt do të zbatohet nga programi DMFAS i UNCTAD-së (agjencia zbatuese). Si rrjedhojë, kontributi i SECO-s siç përcaktohet në paragrafin 1, do të transferohet drejtpërdrejt në llogarinë e UNCTAD-së. Për këtë qëllim do të nënshkruhet një marrëveshje e veçantë ndërmjet

SECO-s dhe UNCTAD-it. Për vënien në zbatim të Projektit do të nënshkruhet Dokumenti i Projektit dhe Marrëveshja e Mirëmbajtjes së DMFAS 6-s ndërmjet UNCTAD dhe Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë.

3. Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë do të kontribuojë për Projektin nga burimet e veta në shumën prej 80,000.00 USD (mekanizmi i ndarjes së kostos).

4. Agjencia zbatuese (UNCTAD), si pjesë e Kombeve të Bashkuara, përjashtohet nga të gjitha taksat e drejtpërdrejta dhe nga kufizimet doganore, tarifat dhe taksat e natyrës së ngjashme në lidhje me artikujt e importuar ose të eksportuar për përdorim zyrtar nga ana e saj, bazuar në Konventën për Parimet dhe Imunitetet e Kombeve të Bashkuara. Për këtë arsye, të gjitha tatimet në lidhje me projektin do të mbulohen nga buxheti i Ministrisë së Financave.

5. Palët Kontraktuese zotohen të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për shmangien e korrupsionit, në veçanti, zotohen që nuk do të ofrohet apo pranohet asnjë pagesë, dhuratë apo përfitim tjetër. Çdo shkelje e kësaj klauzole të integritetit përbën bazë ligjore për zgjidhjen e parakohshme të kontratës bazuar në arsye bindëse. Në rast të ndonjë dyshimi të arsyeshëm në lidhje me sa më lart, Palët Kontraktuese do të njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën.

6. Çdo ndryshim apo amendim i kësaj Marrëveshjeje dhe çdo njoftim dhe deklaratë e bërë nga Palët Kontraktuese sipas kësaj Marrëveshjeje bëhen me shkresë dhe kërkojnë pëlqimin e të gjitha Palëve Kontraktuese.

7. Të gjitha korrespondencat me SECO-n, duke përfshirë çdo lloj dokumenti, raporti dhe dokumente të tjera që lidhen me Projektin, hartohen në gjuhën angleze.

8. Kjo Marrëveshje do të përfundojë nëse përfundon marrëveshja e veçantë ndërmjet SECO-s dhe UNCTAD-it. Në këtë mënyrë, me përfundimin e Marrëveshjes ndërmjet SECO-s dhe UNCTAD-it fondet mund të vazhdojnë të mbahen nga UNCTAD-i derisa të gjitha shpenzimet, duke përfshirë detyrimet e ndodhura, të jenë përmbushur nga ai fond. Kjo do te aplikohet *mutatis mutandis* edhe ndaj burimeve te siguruara nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë.

9. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pasi Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë njofton se janë përmbushur procedurat e brendshme bazuar në legjislacionin shqiptar, dhe ajo do të mbetet në fuqi deri në datën e përfundimit të projektit, siç përcaktohet në Dokumentin e Projektit".

Për Këshillin e Ministrave të
Republikës së Shqipërisë
Shkëlqim Cani
Ministër i Financave
Për Këshillin Federal të Zvicrës
Ambasadori
……
Ambasada e Zvicrës në Shqipëri